



# Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



|                |                                                                                                                   |                     |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| Për :          | Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt<br>Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt |                     |
| Cc:            | Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë              |                     |
| Përmes:        | Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së                        |                     |
| Nga:           | Xhevat Tafa, U. D i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL                              | Datë:<br>05/06/2019 |
| Lënda:         | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt                                                        | Nr. 020-609         |
| Lloji i aktit: | <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës                                                             |                     |

I nderuar Kryetar,

E nderuara Kryesuese,


Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-463/01-0031035/19 për shfuqizimin e vendimit nr. 01/463/02-0061449/18 të datës 30.10.2018 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

I miratuar më datë: 27.05.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.05.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

|             |                                                                                                          |                       |
|-------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|
| Za :        | Bekim Jashari, gradonačelnik Opštine Srbica<br>Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica |                       |
| Kopija:     | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini        |                       |
| Preko:      | Adrijana Hodžić, ministarka MAPL-sa<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u.                     |                       |
| Od:         | Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i<br>monitorisanje opština, MALS                         | Datum,<br>05.06.2019. |
| Predmet:    | Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Srbica                                                        | Br.020/609            |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine                                                                                 |                       |

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

|                                                                                                                                                                          |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Odluka br. 01-463/01-0031035/19 za poništenje Odluke br. 01/463/02-0061449/18 od dana, 30.10.2018. godine, za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine |
| Usvojena dana, 27.05.2019.                                                                                                                                               |
| Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 31.05.2019.                                                                                                                     |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SKENDERAJ / MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

01-463/01-0031035/19  
31 05 2019

|                                                                                                                                                 |                               |                    |                |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------|----------------|
| HYRJE NË ULAZIN (INCOMING)                                                                                                                      |                               |                    |                |
| KOMUNA E KOSOVES / REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO<br>QEVERISJE E KOSOVES / VLAHA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO                          |                               |                    |                |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br>Ministristvo Lokalne Samouprave i Administracije<br>Ministry of Local Government Administration |                               |                    |                |
| Data<br>Date                                                                                                                                    | 31.05.2019                    |                    |                |
| Niveli organizativ<br>Organizational level                                                                                                      | Nr. i Lendës<br>Serial number | Shënime<br>Remarks | Vlera<br>Value |
| -VI-                                                                                                                                            | 020-609                       |                    |                |

Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/ Skupština Opštine/Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të propozim-vendimit nr. 02-463/01-0029899/19, të datës 27.05.2019, në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), Statutit të Komunës nr. 01-110-385, i datës:03.12.2008, neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 neni 53 par.1 dhe 3, neni 57 par.1, neni 58 par.2, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.05.2019 miratoi këtë:

### **VENDIM**

- I. Miratohet propozim- vendimi nr. 02-463/01-0029899/19 i datës 27.05.2019, për shfuqizimin e vendimit të miratuar nga Kuvendi Komunal nr. 01-463/02-0061449/18 i dt:30.10.2018 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatgjatë 30(vite), me mundësi vazhdimi edhe për 10(vite)
- II. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb -- faqen e komunës.

### **Vendimi i Dërgohet :**

1. Arkivit
2. MAPL-së
3. Zyrës së Kryetarit
4. DGJKP-së
5. Dosjes



Kryesuesja e KK-së;  
Znj. Fatbardha Haliti



Republika e Kosovës  
Republika Kosov  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipal of Skenderaj

02-463/02-0061449/18  
30.10.2018

### Kuvendi i Komunës / Skupština Opštine / Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të propozimit Nr.02-463/02-0058525/18, i datës: 11.10.2018, dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), neni 6 dhe 7, i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/12, dhjetor 2012), neni 11, neni 12, të Rregullores QRK nr. 23/2013, Për Përcaktimin e shfrytëzimit dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 14, paragrafi 1, shkronja d) dhe paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, të datës 03.12.2012, dhe në përputhje me mbledhjen e rregullore të mbajtur me datën: 26.10.2018, miratoi këtë:

## **V E N D I M**

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Skenderajt nr.02-463/02-0058525/18, i datës: 11.10.2018, për miratim paraprak të vendimit për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik/ juridik, në shfrytëzim afatgjatë 30 vite, me mundësi vazhdimi edhe për 10 vite.
- II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, prona e paluajtshme në vijim do të jepet në shfrytëzim:
  1. Parcela kadastrale, nr. P- 72015063-00562-3, certifikata e pronësisë nr. 777/18, i datës: 11.10.2018.
  2. Në sipërfaqe të tërësishme prej 1.08.1 Ha, zona kadastrale Skenderaj.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është: Vendosja e Stacionit të Autobusëve që do të ndikon në zhvillim ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e shërbimeve.
- IV. Afati kohor për dhënie e pronës në shfrytëzim është afatgjatë në periudhën për 30 vite, me mundësi vazhdimi edhe për 10 vite.
- V. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes konkursit publik.
- VI. Të drejtat dhe përgjegjësit e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës, organi kompetent për pronë dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme.
- VIII. Ky vendim hyjë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kopje për:  
Arkiv të komunës,  
DGJKP-së,  
MAPL-së,  
Zyrës së kryetarit, dhe  
Dosjes.

Kryesuesja e KK-së:  
znj. Fatbardha Haliti

11.10.2018